



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Zyra e Personelit

Nr.01/231

Më:24/02/2017

Në mbështetje të dispozitave të nenit 11, të Ligjit për Shërbimin Civil në Republikës së Kosovës, nenit 15 dhe 17 të Rregullores Nr. 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Udhëheqësi i Personelit me date, 24.02.2017, shpall:

K O N K U R S
Për plotësimin e vendit të lirë të punës

I. ZYRA E KRYETARIT

1. Pozita: (Një) Udhëheqës i Njesisë së Komunikimit Publik.

Kushtet : Kualifikimi i lartë -Diplomë Universiteti.

Përvoja e punës : 5 vite.

Koeficienti : 8

Kodi i vendit të punës IN/010

Mbikëqyrja: Kryetari i Komunës

Përshkrimi i detyrave të punës:

- Udhëheqja e shërbimit të informimit publik
- Përcjellja e mbledhjeve të Kuvendit dhe mbledhjet e Këshillit të Drejtorëve;
- Informimi i shtypit për vendimet e marra në Kuvend dhe Këshilli i Drejtorëve;
- Informimi i Këshillit të Drejtorëve për shkrimet e gazetave përkritazi me Kuvendin e Komunës dhe Shërbimin Civil të Komunës;
- Reagimi ndaj shkrimeve tendencioze,
- Përgatitja e buletinit mujor lidhur me informacionet dhe ngjarjet që kanë ndodhur gjatë muajit në Komunë;
- Mirëmbajtja dhe administrimi i ueb-faqes zyrtare;
- Informimi paraprak për ngjarjet në komunë;
- Përgatitja e broshurave për sektor të caktuar të administratës;
- Përgaditë raporte të rregullta pune;
- Punë dhe obligime të tjera në bashkëpunim me udhëheqësit e komunës;

Dokumentet që kërkohen:

- Diplomë Universiteti
- Vërtetimi që nuk është nën hetime
- Çertifikata e lindjes
- Kopja e letërnjoftimit
- Dëshmi e përvojës së punës

Të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të aplikojnë në këto vende të punës janë të obliguar që t'i marrin dhe dorëzojnë aplikacionet në **Zyrën për pritjen e palëve** të KK- Malishevë.

Konkursi do të mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e shpalljes së tij në të përditshmen: **"Epoka e re"** dhe në tabelë të shpalljeve të **KK- Malishevë**.

Për datën dhe kohën e mbajtjes së intervistës dot njoftoheni me kohë.

Udhëheqësi i Personelit
Gani Bahtjaraj, jur.dipl.

